


ISMAIL KADARE

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-1

K 14

Në
muzeun
e
armëve



poemë

814-1

K14.

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

ISMAIL KADARE

**NË
MUZEUN
E ARMËVE**



74258

12870

POEMË

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

*Kjo poemë ka fituar çmimin e parë në konkursin e
letërsisë për fëmijë të shpallur nga Shtëpia Botuese
«Naim Frashëri» në vitin 1977.*

ISMAIL KADARE

ME
FRASHËRI
E BASHKËPUNË
PËR
PËR
PËR



Tirazhi 6000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Kombinati Poligrafik – SHTYPSHKRONJA e Re Tiranë, 1978

HAPJA E MUZEUT TË ARMËVE

Kjo kështjellë e moçme,
Me kullat në re,
Hapi portat e rënda,
Kur gdhiu ditë e re.

Kërkëllitën ankueshëm
Zinxhirët e fortë.
Që lart pyetën kullat:
Ç'po ndodh atje poshtë?

Nëpër portat e larta
Vargan-vargan
Hynin njerëz e kuaj,
Ngarkuar me armë.

Po ç'janë këta kuaj
Po ç'janë këto armë
Pyetnin muret e vjetra
Dhe bedenat me radhë.

Ja, kulla e jugut
Qeshi ho, ho, ho:
Më ngjan se atë top
Unë po e njoh.

Më ka gjuajtur dikur
Gjyle e tij e zezë,
Në s'gabo, ti je topi
Turk «Balljemez».

Uli tytën topi,
Sikur thoshte «po».
Shih, pa shih, thanë kullat
Ç'armë qenkan këto!

Ja mortaja italiane,
Jatagani turk.
Po një pjesë të tyre
Ne i njohim qyshkur

Gjylet, predhat e tyre
Mbi kokë na kanë rënë,
Dhe hekuri i tyre
Kafshonte me dhëmbë.

Mitralozi «Shars»,
Topi austriak.
Tytat i kanë
Me blözë e me gjak.

Ja zinxhiri i tankut,
Që te porta u ngjit.
Ja krahu i avionit
Të zi «Mesershmīt».

Radhë-radhë mbuluar
Me baltë e me ndryshk,
Po hyjnë në kështjellë
Këto armë armiqsh.

Me tytat e ulura,
Mbuluar me turp.
Ca mbetur pa rrota,
Ca mbetur pa trup.

Dhe kullat po pyesin:
Përse vallë i mblodhën
Këto armë të vjetra,
Tek ne pse i sollën?

Këto armë të dikurshme
I sollën, sepse
Në kështjellën e moçme
Do hapet muze.

Ja, nga porta tjetër
Po hyjnë vargan
Pushkë partizane,
Mitrалozë partizanë.

Gjerdanë dhe bomba
Të shokëve dëshmorë,
Revolja e Hulos
Atentator.

Dhe shpata të moçme,
Mburoja si mur
Me të cilat luftuan
Gjyshërit dikur.

Armë të vjetra,
Armë të reja,
Rrinë pranë e pranë
Si dje në beteja.

Të gjitha këto
Po mblidhen tani
Në muzeun e armëve
Plot lavdi.

Gjithë ditën e ditës,
Gjer në mbrëmje thellë,
Vazhdoi futjen e armëve
Në kështjellë.

Pa mbërritën me radhë,
Pa vijinë që larg
Pushkë dhe topa
Italianë, austriakë.

Bomba, autoblinda
Me lloj-lloj marka,
Lloj-lloj emblema
Vendesh të largëta.

Të gjitha armët
I vunë në rresht
Kubetë e rënda
Heshtnin përreth.

Pastaj njerëzit ikën,
U mbyll porta pastaj
Mbretëroi heshtja e thellë
Rreth e qark, në çdo skaj.

Ndonjë zhurmë qyteti
Vinte tej që matanë,
Të qeshura njerëzish,
Autobusat urbanë.

Sirenë e uzinës
U ndje që larg...
Pastaj heshtja e armëve
U prish pak nga pak.

Si ca njerëz të njohur,
Që i mbledh rasti diku,
Nisën armët pëshpërimën,
Një aty, një këtu.

Bisedojnë ato mbytur
Në mesnatën e qetë.
I flet shpatà shpatës,
Topi topit i flet.

Nga ke ardhur zotrote,
Nga ç'vend je, ç'emër ke?
Un' jam nga Berlini,
Po zotrote nga je?

Unë jam turk, allahile,
Nga Stambolli jam,
Balljemez e kam emrin.
Kurse unë Haufman.

Ç'moshë ke, vallë, zotrote?
O jam plak, ç'më pyet.
Jam nga kohë e mesjetës,
Pesëqind e ca vjet.

Huu, sa i moçmë që qenke!
Kurse i ri jam vetë.
Luftë e Parë Botërore,
Viti katërmbëdhjetë.

Ka akoma armë
Më të reja se ne.
Ej, ti, çun, piçiruk,
Ç'emër, ç'moshë ke?

Mitralozi Breda
Un' jam, sinjore!
Datlindja dyzetë
Luftë e Dytë Botërore.

Tani luftrat kanë numra,
Tha topi plak.
Në kohën tonë
Ato kishin veç gjak.

Dhe kështu pëshpëritin
Një këtu, një matanë,
Turq, gjermanë, normandë,
Romakë, italianë.

Kur ke ardhur së pari
Në Shqipëri?
N'atë vit të mallkuar
Dyzetedy.

Unë kam ardhur më herët,
Nga kufiri verior.
Ju nga toka mbrritët?
Ne me vapor.

Po ku qenke çarë
Kështu për ibret?
Në rrethimin e Krujës
U gjymtova keq.

Kurse unë këtë vrimë
Te gryka ma sheh?
Ma hapën partizanët
Nëntor dyzetetre.

Ja dhe gjermani,
Zoti Haufman.
O, kush po kalon,
Agai-jatagan!

Ç'qenkan mbledhur të gjithë,
Pa shih, pa shih!
Me gjuhë të ndryshme,
Kalibra, gjatësi.

Dhe vazhdojnë njohjet
Një këtu, një atje.
Si je, herr mitraloz,
Si je, Balljemez be?

Avioni amerikan?!
Avioni spiun?
Po ti ç'do këtu,
Po ty qysh të zunë?

Si? Si? Fol më fort,
Ç'pëshpërit, o i ngratë
Me motor të shuar...
Pa zë... një natë...

Si? Si? Më plase,
Nuk të marr vesh.
Po zë ti s'paske,
Avion memec.

Oh, e kuptova:
Avion hileqar,
Gjithë jetën i fshehtë,
Pa zë, tinzar.

Me motor shuar,
Fshehtas, pa zhurmë.
Spiun i mjerë
Gjersa të zunë.

Ndaj nuk flet dot,
Veç bën pësh-pësh;
Kështu gjithë jetën
Ti do të bësh.

Kështu flasin armët,
Kujtojnë kohën e largët.
I tregojnë njëri-tjetrit
Emrat dhe plagët.

Dhe ti këtu qenke,
Sinjora autobлиндë?
Ç't'i bësh, zoti tank,
Pa fat paskam lindur.

Po pse na kanë mbledhur,
E more vesh vallë?
Thonë se do hapet
Një muze i madh.

Të vijnë varg njerëzit,
Të qeshin me ne...
Ah, kështu qenka puna!
Ç'më the, ç'më the.

S'ma merrte mendja,
Zoti tank, ta dish,
Që nën talljet e njerëzve
Pleqërinë ta ngrys.

Ç't'i bësh, moj zonjës,
Këtë fat patëm ne.
Gjersa u thyem,
Do na vënë në muze.

Gjithë natën pëshpërimat
S'pushuan aspak,
Nën muret e larta,
Nën kubetë me hark.

Ja, erdhi mëngjesi,
Ja, dielli ra
Mbi bedenat e moçme,
Mbi kullat e mëdha.

U hap portë e rëndë
Me gjënim, kërkëllimë,
Dhe njerëzit vërshuan
Në varg pa mbarim.

Hynin, ndalonin
Te topat, te armët,
Historitë e tyre
I dëgjonin me radhë.

Ngjarje të moçme,
Ngjarje të reja...
Pranë armës rri arma,
Pranë betejës beteja...

Me javë e me muaj
Ata vijnë rresht,
Portë e kështjellës
Që larg i pret.

Portë e muzeut
Rri hapur gjithnjë...
Eja të hyjmë
Edhe ne nëpër të!

UDHËZIM PËR VIZITORËT!

Tani ngadalë ne do t'ecim,
Mes armësh do të vijmë përçark,
Do t'i shikojmë ato me radhë,
Do t'u dëgjojmë zërin që larg.

Tytat e tyre porsi gojë
Tregojnë ngjarje e histori,
Tregojnë armiqtë si u mundën
Dhe tanët si fituan lavdi.

Ne do të ecim midis tyre,
Do t'i dëgjojmë ato me radhë.
Se historitë që ato tregojnë,
Janë pjesë e historisë së madhe.


SHPATA DHE JATAGANI

Ja ku rrijnë përballë
Si atëherë, si qyshkur:
Shpata shqiptare,
Jatagani turk.

Është e drejtë shpata,
Gjithçka e ka drejt.
Kurse shih jataganin,
I shtrembër është krejt.

Këtë shpatë të moçme,
Bërë për luftë e tufan,
E gdhendi një mjeshtër
Plak kruetan.

Ia kaliti millin
Në farkën e tij,
Te doreza i gdhendi
Fjalën «Shqipëri».



~~74258~~

Luftëtarit Gjon
Shpatën ia dhanë,
Që të nisej me të
Në tramundanë.

Kurse ky jatagan
I shtrembët aziatik
Në thellësi shkretëtirash
Diku u lind.

U lind për të liga,
Për pushtim e rrebesh,
Nga fundi i Azisë
U nis drejt nesh.

Krahas armësh të tjera,
Jataganësh të ligj,
Vinte jatagani
Aziatik.

Milli i tij lëshonte
Një dritë të vrarë.
Mbi dorezë të tij:
Një mbishkrim fetar.

E mbante në dorë
Turku Hasan,
Të egrin, të shtrembtin
Jatagan.

Ushtria osmane
Afrohej me ngut.
Devetë me topa
Ngarkuar mbi trup.

Ecnin jeniçerët
Vargan-vargan.
Midis tyre marshonte
Ushtari Hasan.

Ushtria shqiptare
Po vinte përballë
Si një det me shkumë,
Si një det me valë.

Dhe erdhi dita
Plot re dhe lavdi,
Shpata me jataganin
Të ndesheshin të dy.

Shqiptari Gjon,
Turku Hasan,
Në fushë të betejës
Përballë seç janë.

E drejtë shpata,
Rrezëllin si ar,
Gërmuqet jatagani
Tinzar, hileqar.

Jatagani i shtrembër,
Jatagani dinak,
Jatagani që erdhi
Të na mbyti që larg.

Dhe nisën betejën
Ushtarët me mija,
Armët, tek ndesheshin,
Lëshonin shkëndija.

Midis tyre Gjoni
Me turkun Hasan
Luftojnë e goditen
Me shpatë, jatagan.

Të drejta goditjet
Jep shpata si zjarr.
Bën dredha, lakohet
Jatagani tinzar.

Dhe ndeshen, përleshen
Rrufe nëpër re,
Dy vende të ndryshme
Dy botë, dy ide.

E drejtë njëra botë,
Si shpata që mban,
E shtrembër është tjetra
Me jatagan.

Dhe ndeshen, përleshen
Turq e shqiptarë:
Shpatat e çiltëra,
Jataganët tinzarë.

Përleshet Gjoni
Me turkun Hasan.
Gurët përreth
Me gjak u lanë.

Dhe ja papritur,
N'atë lëmsh e re,
Jatagani në pluhur
Seç ra përdhe.

Dhe ra Hasani
Me gjithë jatagan.
Koka këtej,
Çallma matanë.

Pluhuri, gjaku
U përziën mbi bar,
Mbi armët e turkut,
Mbi mbishkrimin fetar.

Midis qindra ushtarësh
Të vdekur turq,
Mbet si jetim
Jatagani gërmuq.

3 —

Ajo ditë e tmerrshme,
Ajo luftë dikur,
Ende i kujtohet
Jataganit turk.

I kujtohet i zoti,
Kur jeta e la,
I kujtohet pastaj
Në pluhur si ra.

O ç'tmerr qe ai,
O ç'turp qe ai!
Shumë shekuj kanë shkuar
Luftra, stuhi.

Po kurrë s'harrohet
Ajo rënie me turp,
Rënia në pluhur
E jataganit turk.

Akoma tani,
Tek rri në muze,
S'i hiqet nga mendja
Ajo ditë me re.

Dhe rri i fyer,
I mvrojtur rri.
Shpata përballë
Ndririt plot lavdi.

Shpata q'e mundi,
Q'e hodhi përdhe,
Ajo, që shkrepse
Porsi rrufe.

Njerëzit qëndrojnë
Përpara saj,
Plot me nderim
Flasin pastaj.

Kurse ai
Ndien veten keq
Ashtu mënjanë
I krrusur krejt.

Edhe mendon:
Katërqind vjet
Me këtë turp
Jetoj një jetë.

Edhe mendon:
Mijëra vjet
Te ky muze
Do rri medet!

Te ky muze,
Me këtë turp.
Shpata përballë,
Unë në një skutë.

Ajo plot dritë,
Unë pisë i zi,
Me lavd ajo,
Unë pa lavdi.

I shtrembër unë,
Ajo e drejtë
Gjithmonë kështu,
Kështu përjetë...
Medet, medet!

UDHËZIM PËR VIZITORËT!

Mjaft, jatagan... Armët e tjera
Përreth kanë hapur tytat-gojë...
Ta lëmë në qoshe jataganin
Edhe më tutje ne të shkojmë.

Ashtu siç na e tha dhe vetë,
Përballë shpatës plot lavdi
Gjithmonë i shtrembët ai do mbetet,
Siç ish e shtrembët kauzë e tij.

Pra, le të shkojmë tani më tutje
Nëpër kështjellën lavdiplot.
Armë të tjera po na presin,
Një top i madh... Po ç'është ky top?

TOPI TURK

I

Ky top këtu, me grykë të gjatë,
Është topi i madh i famshëm turk.
Bashkë me ushtrinë otomane,
Mbi tokën tonë ai u duk.
Buaj të shumtë e hiqnin branë
Atë përbindsh, atë lubi.
Dhe toka dridhej anembanë
Atje tek shkelte rrotë e tij.
Ushtria ecte dalngadalë,
Shtjellej si gjarpër i pafund.
Zymtohej fusha, mvrejtej mali,
Shkretohej heshtur çdo katund.
Dhe pas ushtrisë vinte topi,
E tmerrshmja armë përmbi dhe.
Atje sulltani kishte shpresën,

Ushtria shpresën kish atje.
Se ish e para herë në botë
Që derdhej top i tillë vigan,
Ai kështjellat do rrafshonte,
Do shtypte popujt anembanë.

Dhe, kur e derdhën, bënë festë,
I vunë emrin «Balljemez»,
Që do të thotë «Top që s'ha mjaltë»,
Por ha kështjella edhe njerëz.
Kish dhënë urdhër vetë sulltani:
Kundër rebeles Shqipëri
Të nisej top i madh i famshëm.
Të bënte tmerr, të bënte zi.
Dhe ja tani ai po vinte
Rrethuar me legjenda plot.
Kasnecët botës ulurinin:
U nis, u nis i madhi top.
Dhe qanin njerëzit zemërpulë,
E mjera ti, moj Shqipëri,
Qysh do durosh këtë mynxyrë,
Këtë kamzhik e batërdi.
Dhe vinte varg e varg ushtria,
Dhe nxinte tutje topi tmerr,
Nëpër kështjella Shqipëria
Armikun priste si përherë.

Daulle e luftës ra në fushë
 Dhe topi i madh krisi atje.
 Gjëmimi i tij qiellin mbushi;
 Si t'ishin bashkë njëqind rrufe.
 Kjo ishte gjyle e tij e parë...
 Sa gjyle shtiu ai top
 Dhe çau mure, vrau ushtarë,
 Porse kështjellat s'mori dot.

U dëshpëruan pashallarët
 Dhe bënë lutje, bënë vaj.
 Rrahën topçinjtë, rrahën ushtarët,
 Sikur të kishin ata faj,
 Prap topi shtiu, por fati i luftës
 Prej tij nuk ndrroi as dhe një çikë.
 Aherë ata krejt të tërbuar,
 E rrahën topin me kamzhik.

Pasi e rrahën mirë e mirë,
 E vunë të shtinte përsëri.
 Gjylja në mure bënte vrimë,
 Por jo në zemra, kursesi.
 Ata s'kuptonin se një popull,

Kur për lirinë e tij del zot,
Nuk ka ushtri që t'ia ulë kokën,
Dhe nuk ka gjyle e nuk ka top.

3 -

Larg në Stamboll, Sulltani i vrërët
Nga Shqipëria priste lajm.
Përse korrierët po vononin,
Si shkonte lufta, fati i saj?
Kryeqyteti i tërë priste
Mposhtjen e vendit shqipëtar.
Legjendë e topit rritej, rritej,
Si flaka në një fushë me bar,
Për të poetët bënin vjersha,
Tek rrinin nëpër kafene:
O top i madh, o top i tmerrshëm,
O topi plak, je shpresë për ne.

Dhe në pallat, i zyrtë sulltani
Po priste lajme përsëri.
Korrierët rendnin si tufani,
Por lajmet ishin zi më zi.
Ndërkaq atje, në fushë të largët,
E rrihnin prapë topin plak.
Vazhdonte lufta ditë e natë
Dhe digjej shkrumb e derdhej gjak.

Një natë, mbi ushtrinë turke
 Sulmoi papritur Skënderbeu.
 Me llahtari ranë daullet
 Nën thundra kuajsh u drodh dheu.
 Përleshja ishte e gjatë, e egër,
 Ushtria u gjakos, u pre.
 «Allah, allah!» thërritnin turqit,
 Kurse shqiptarët «Skënderbe!»

N'agim, gjithë kampi qe shkatruar,
 Çadra, kufoma rreth e qark.
 Dhe mbeturinat e ushtrisë
 U nisën dalngadalë larg.
 Ikën të mundur, peshë e turpit
 Kërruste njerëz dhe deve.
 Dhe lanë pas armë e flamure,
 Dhe topin plak e lanë atje.

Në baltë i zhytur gjysmë pash,
 Përgjysmë futur në hendek,
 Kish ngecur topi i madh i famshëm,
 I katandisur mos më keq.
 Grykë e mynxyrshme, që kish vjellur

Aq gjyle e vdekjes e blozë të zezë,
Tani përpara ishte nderur
Si qafë e kalit që po vdes.

5 -

Atje u gdhi i vetëm fare.
E panë fshatarët në mëngjes.
Një copë herë erdhën vërdallë
Te trupi i tij, te grykë e zezë.
Pa shih, pa shih, është topi i famshëm!
Si qenka bërë baltë, shih!
Dhe ata qeshën gjithë me radhë
Me topin plak, topin lubi.

O top, si qenke katandisur,
O top; pashai ty qysh të la.
O topi turk, që nuk ha mjaltë,
po vetëm koka popujsh ha!
Pa hiq pak tani mënjanë,
Se na pengon të mbjellim grurë.
Dhe topin shtynë ata matanë,
Te cepi i arës, te ca gurë.

Dhe tek e shtynin dalngadalë,
Gjithë trupi i tij nxirrte gërvimë.
Dukej sikur ajo rrangallë
Nisi të qante me vajtin.
Dhe, si e lanë atje mënjanë,
Te cepi i arës në vetmi:
O top i tmerreve, i thanë,
Ti, që solle zjarr e zi,
Ti, që na erdhe për të na zhdukur,
Që vdekje të na sjellësh ngado,
Vështro tani si mbjellim grurë,
Dhe si jetojmë ne, vështro.

6 -

Kaluan vitet. Topi mbeti
Aty te ara, mu në skaj.
Vazhdonte lufta prapë e rreptë,
Sepse ajo ish kohë e saj.
Vinin ushtritë mbretërore
Vargan-vargan e gjithënjë.
Vinin me zhurmë e me daulle
Dhe iknin heshtur e pa zë.

Shumë pashallarë morën urdhër
Ta marrin topin madhështor.

Ta lidhnin prapë pas deveve
Edhe ta çonin në Stamboll.
Atje ta shpinin në punishte,
Ta ndreqnin prapë me kujdes.
Kështu që prapë zjarr të villte,
Të villte vdekje grykë e zezë.
Mirëpo asnjë pasha s'u kthye,
Asnjë ushtri nuk pati kthim.
Kështu që topi prapë mbeti
Te cepi i arës si jetim.

7 --

Kështu, tek ai cep i fushës
Kalonte ditët në vetmi.
Në dimër, bora e mbulonte,
Në vjeshtë qull bëhej në shi.
Dhe rrotull gruri shushurinte
Dhe gjuhë e huaj ish përreth.
I huaj ditët ai ngryste,
Top i braktisur «Balljemez».

Vinin pranverat, vjeshtat ikinin,
Zverdheshin, mbinin lule e bar.
Ndërsa atë te cepi i arës
E mbuloi ndryshku dalngadalë.

Ashtu i ndryshkur, i braktisur,
Kalonte vite e qindvjeçarë,
Te kjo kështjellë për të mbritur,
Te ky muze i madh shqiptar.

Ja, kjo qe historia e topit,
Që erdh dikur si një përbindsh.
Që me lavdi dot s'u mbulua,
Por u mbulua veç me ndryshk.
Që rri përpara nesh i heshtur,
Me grykën ulur tani krejt.
Që veç si temë për hartimin
E nesërm ty mund të shërbejë.

UDHËZIM PËR VIZITORËT!

E gjatë ish histori e topit,
Si tytë e tij mbushur me ndryshk.
Topa të tjerë pranë i rrinë,
Plot historira sigurisht.

Pavarësisht nga shtetet, markat,
Të njëjtin fat patën ata,
Ndaj historitë i kanë të ngjashme
Plot krisma, gjyle të mëdha.

Tani secili po ngre tytën
Që të tregojë diçka, po ne,
Ngaqë nuk duam përsëritje,
Ikim më tutje në muze.

Një pushkë të gjatë kemi përpara,
Si libër i hapur ajo ngjan,
Në historinë e saj do gjejmë
Një shekull luftë dhe tufan.

P U S H K A

1 .

Në fillim s'qe pushka...
Dy dele e një dash
Zbardhonin në pllajë,
Kullotnin në rrafsh.

Kështu qetë-qetë
Nis kjo histori,
Me qumësht dhe zile,
Bjeshkë e bardhësi.

Ca njerëz të varfër,
Në bjeshkën me borë,
Kjo kopezë e vogël
Ushqente me zor.

Por një ditë prilli,
Malësori Preng
Rrinte i menduar,
Në sy kish një brengë.

Delet po kullotnin
Aty në livadh,
Në ballin e Prengës
Një mendim i madh.

Pak qumësht, pak misër
Kullë e Prengës ka,
Po supit të tij
I mungon diçka.

O, supit të Prengës
Pushka i mungon.
Ndaj dhe sytë e tij
Erren si një hon.

Se burri pa pushkë
Është gjysma-burrë.
Ndaj jetën pa pushkë
Prenga s'e do kurrë.

Duhet pushka, duhet
Për gëzim, për helm.
Shoqe më besnike
Malsori nuk gjen.

Koha vjen e turbullt,
Stinë të mëdha...
Po supit të Prengës
I mungon diçka.

Ndaj rri ngrysur Prenga,
Ndaj merr një vendim:
Dy dele të shesë
Të blejë një martinë.

Dy delet dhe dashin
Së bashku me to...
Është kohë e ashpër,
Varfëri kudo.

Do të vuaj' Prenga,
Da të hajë më pak;
Po ç't'i bësh, pa pushkë
S'çohet jeta aspak.

2 -

Dhe u nis një ditë
Malësori Preng.
Dy delet dhe dashin
I nxori në treg.

I shiti të tria,
Shkoi kopeja krejt.
Në pazar të armëve
U sul ai shpejt.

Me paret e deleve
Bleu një pushkë të gjatë.
Dhe me të në krahë
U nis për në fshat.

Ecte, ecte Prenga,
Ikte nëpër muzg.
Ish një mbrëmje e ngrysur,
Ish një qiell pus.

Tek ecte, i dukej
Se ndiente përçark
Herë një blegërimë,
Herë një zile larg.

Por s'e ndali hapin,
Por kokën s'ktheu pas...
Kishte dash e dele,
S'ka më dele e dash.

Kishte zile, qumësht,
Tani armë ka...
Koha vjen e ashpër,
Stinë të mëdha.

3 —

Kështu hyri pushka
Në kullën e tij,
Ashtu siç hyn nusja
Një ditë në shtëpi.

Pjesëtare e familjes
Ajo shpejt u bë.
Në helme e gëzime
Gjendej gjithnjë.

Në pritë e gjakmarrje,
Në dasmë e varrim,
Grykë e saj e gjatë
Lëshonte gjënim —

Iknin javët, muajt,
Stinë të ashpra varg.
Dhe plakeshin njerëzit,
Por pushka s'u plak.

Herë mbi supe njerzish,
Herë varur në mur.
Jetës njerëzore
S'i mungonte kurrë.

Iknin muajt, vitet,
Atje lart në rrafsh.
Ajo ish mes tyre,
Jetë e vdekje bashkë.

4 —

Një daulle binte
Lugjeve përpjetë,
Marshon një ushtri,
Po ç'ushtri të jetë?

Bjeshkës dimërore
Fluturon një lajm,
Është i zi si korbi,
S'është lajm, po vaj.

Vjen ushtria turke
Me daulle prapë,
Malësi e alpe
Do t'i bëjë zap.

Vjen t'u marrë armët
Shqiptarëve sërish,
Zvaritet si gjarpër,
Hunguron si bishë.

Bjeshkës dimërore
Fluturon ky lajm:
Në krye t'ushtrisë
Ësht' Turgut pashaj.

Është i egër shumë
Ky pasha osman.
Shkatërron me top,
Pret me jatagan.

Me armët shqiptare
Do të bëjë një pîrg!
Kështu paska thënë
Ky pasha i lig.

Bjeshkës hapet fjala,
Nga skaji në skaj:
Dashka armët tona
Të na marrë pashaj.

Të na zhburrëzojë
Ky pasha i lig.
Trupin tonë të gjatë
Ta bëjë shkurtabiq!

Ah, pasha i turqve,
Shqiptarët s'i njeh.
Armët tona do?
Ja, pra, ku i ke!

Edhe krisnë armët
Edhe u struk pashaj,
Nisi luftë e egër,
Nisi valle e saj.

Ngriheshin drejt qiellit
Viganë, madhështorë.
Malet e ngarkuar
Me armë e dëborë.

Seç gdhinin më luftë,
Ngryseshin me të.
Ortekët u struknë,
Zogjtë s'nxirrnin zë.

Armët dot s'i mori
Pashai turkoshak.
Sprapsej thellë malesh
Llangosur me gjak.

5 -

Te kulla, në bjeshkë,
Mes alpesh atje,
Erdh Prenga nga lufta
Një mëngjes me re.

Ç'ka sjellë nga lufta,
Ç'kujtim nga beteja?
Tri plagë të rënda
Në gjoks që të treja.

Po pushkën e gjatë
E mbante në sup.
Si lisi mbi breg
Qe pushka mbi sup.

Rreth tij seç i mblodhën
Fëmijë edhe gra.
Dëgjoni, të gjithëve,
Ky Prenga iu tha.

Tri plagë të rënda
Në gjoks unë i kam.
Dhe sot jam mes jush,
Po nesër nuk jam.

Ti, djalë, merre pushkën
Dhe mbaje me nder.
Kushtrimi n'u dhëntë,
Shpejt malet i merr.

Dhe dije ti, grua,
Ti, djalë, e ti, plak,
Se pragu i shtëpisë
Nuk është ky prag.

Po pragu i shtëpisë
Ësht larg, shumë larg,
Kufiri i vatanit,
Ai është prag.

Te pragu i vendit
Prapë hasmi në ardhhtë,
Të nisesh ti, bir,
Me pushkën e gjatë.

6 —

Kaluan prapë vite
Me dimra, me luftë.
U nis djali i Prengës
Me pushkën në sup.

U nis e u kthye
Dhe prapë seç u nis,
Dhe ra në një luftë,
Siç bie një lis.

Dhe shokët e tij
E sollën një natë
Të shtrirë mbi vig,
Bri pushkës së gjatë

7 —

Kështu shkonin vitet,
Me dimra me vjeshta.
Dhe nipat u rritën
U rritën dhe mbesat

Dhe plakeshin njerëzit,
Të tjerë lindnin varg,
Veç pushka e moçme
Nuk plakej aspak.

Pjesëtare e familjes
Në gaz e në helm..
Kushtrimi ra prapë,
Prap çohuni, djem!

Po ç'hasm doli vallë
Atje në kufi?
Ti mos pyet më mirë,
Po nisu veri.

Nisu shpejt, o djalë,
Ec përpara, shko.
Shqipërinë dikush
Kërkon ta coptojë.

U nis nipi i Prengës,
U nis nëpër vjeshtë..
Ishte viti i zymtë
Nëntqind trembëdhjetë.

Dhe luftoi në brigje
Dhe luftoi në lugje...
Opingat e zeza,
Me xhufkat e kuqe.

8 -

Kohë e mbretërisë
Erdh në Shqipëri.
Malet seç u thinjën,
Fushat mbanin zi.

Mbreti Zog i egër
Sundon si katil.
Lulet janë tharë,
S'këndon një bilbil.

Po shet Shqipërinë
Mbreti Zog i zi...
Pushkë e gjatë e Prengës
Në mur varur rri.

Vërtiten rreth pushkës
Prifti dhe agaj.
Me të mirë e marrin
Dhe i thonë asaj.

Harro, pushkë, luftrat,
Kur ia bëje bum!
Vraj ti për gjakmarrje,
Vraj ti për kanun.

Kështu pëshpëritin
Prifti dhe agaj.
Vërtiten rreth saj
Dhe i thonë vraj!

Po pushka zyrtore,
E varur në mur,
S'gjëmon për gjakmarrje,
S'gjëmon për kanun.

Pret kjo pushkë e gjatë,
Pret ajo në mur.
Shqipëria luftën
Nuk e harron kurrë.

9 —

Prill, tridhjetë e nëntë,
Qielli u nxi krejt.
Sulmon Italia
Me ajër e me det.

Po zbarkojnë topat,
Tanket me zinxhirë.
Shqipërinë ta vdesin,
Shqipërinë ta lidhin.

Nisen pranë detit
Shqiptarët varg,
Armikun ta presin,
Të vdesin në prag.

Me një pushkë në krahë
Dhe me një gjerdan.
Ca ranë në kodra,
Ca në brigje ranë.

10 -

Nisi luftë e madhe
Nëpër Shqipëri,
Italianë, gjermanë
Si korba të zinj.

Ca ikin, ca vijnë,
Ca futen në dhe.
Pushkë e gjatë e Prengës
Prapë gjëmon atje.

Pushka e dikurshme,
Dy dele e një dash...
Një shekull me luftë
Mbushi dalngadalë.

Nëpër batalione
Partizane ajo,
Nga dora në dorë
Bën luftë kudo.

Vjetëruar druri,
Po s'ka gjë, s'ka gjë.
Tytë e saj e gjatë
Nxjerr plumb gjithënjë.

Nga dora në dorë,
Nga krahu në krah,
Lajmëron kjo pushkë
Kohërat e mëdha.

Në kondak të saj,
Si në lapidar,
Emra partizanësh
Gdhendur radhë-radhë.

Në kondak të saj,
Si në monument,
Luftrat shekullore
Gjëmojnë përjetë!

UDHËZIM PËR VIZITORËT

Pra, siç e pamë, kjo pushkë e gjatë
Po ngjan tamam me një kronikë,
Me ngjarje, luftra dhe me data,
Një kalendar i madh epik.

Shënjestra e saj, që nëpër vite
Qindra armiq në ballë ka parë,
Tani vështron armët e tjera,
Si sy i hekurt e krenar.

Ja pranë saj dhe autoblanda,
Arnuar, shembur për ibret,
Nuk i durohet sa ta thotë,
E mjera, historinë e vet.

TREGIMI I ZONJËS AUTOBLINDË

Ditën kur dola nga fabrika
Isha e re, oh, sa e re.
Më ndriste trupi i çeliktë
Tek shkelte rëndshëm përmbi dhe.
Në këmbët poshtë kisha zinxhirë,
Një mitraloz mbi shpinën lart.
Dhe ashtu të lyer si pasqyrë
Më çuan mua në paradë.
N'atë paradë, Duçja fliste,
Premtonte toka dhe lavdi.
Përpara, armë të fashizmit,
Tej detit larg, në Shqipëri!
Dëgjoja Duçen se si fliste
Dhe ëndërroja unë me zjarr
Që sa më parë të na niste
Në luftë, në truallin shqiptar,

Dhe erdhi ditë e dëshiruar,
Nuk na ngarkuan në vapor.
Në breg, një turmë e pambaruar
Po na i bënte ne me dorë.
U nis vapor i rëndë-rëndë
Dhe çante dallgët nëpër det.
Mendoja ditët që do vinin,
Mendoja fatin që më pret.
Krenare unë do të kaloja
Mes Shqipërisë tej e mbanë
Tok me vëllezërit e mi tanke,
Me kushërinjtë aeroplanë.
Shqiptarët gjithë do t'i habitnim,
Në gjunjë do uleshin ata.
Ku kishin parë autobllinda
Dhe armë të reja të mëdha!
Ata veç një, një pushkë të shkretë,
Na thanë, mbanin përmbi shpinë.
Dhe shumë shumë ndonjë bombë
A ndonjë shishe me benzinë.
Dhe unë mendoja lavdinë time,
Kur të marshoja n'atë vend,
Unë, zonja e bukur autobllindë,
Që do t'i lija gjithë pa mend.

Ndërkaq vapor i afrua
Te bregu lart, plot shkëmb.
Filloi zbarkimi i ushtarëve

Edhe i topave të zinj.
Zbarkuan tanket dhe pas tyre
Zbrita dhe unë atje në zall,
Nisi motori të punojë
Dhe nisa unë një vrap të madh.
Drejt thellësisë së Shqipërisë
Ecja e dehur, gjithë gaz,
Kur befas një breshëri plumbash
Përmbi fytyrë m'u përplas.
O, ç'fyerje e rëndë qe kjo goditje,
O, kjo shuplakë në befasi!
Ndalova, ngrita mitralozin
Dhe shtiva, shtiva plot furi.

Një zemërim i shpejtë, i egër
Më dridhte krejt n'atë xhade.
Kush kish guxuar të qëllonte,
Kush rrugën më kish prerë atje?
Dhe tek mendoja se ç'hakmarrje
Do bëja mbi armiqtë e mi,
Befas një bombë e vogël dore
Më hodhi ciflat në turi.

O, ç'sjellje e keqe dhe barbare,
Sa i përbindshëm ish ky gjest!
E bukura ngjyrë në fytyrë
M'u zhvoshk, më plasi për ibret.

Me sa kujdes më kishin lyer
Ah, bojaxhinjtë në fabrikë
Më kot s'më thërritnin që të gjithë
Zonja, sinjora autobлиндë.
Dhe ja tani lëkurë e bukur
Nga ciflë e bombës seç m'u ça,
Nga dhembja dhe tërbimi i egër
Unë u vërsula përmbi ta.
U egërsova, u harbova,
Zinxhirët nxirrnin pluhur, tym.
Një fshat përpara seç më doli,
Mes tij u sula me tërbim.
Desha të mbytja dhe të shkelja
Gjithçka që kishte n'atë fshat:
Kasolle, pleq e gra e dele;
Zinxhirët të kullonin gjak.

Mirëpo ky fshat qe i braktisur.
Ndaj s'dija si të shfryja dot.
Aherë unë, si e lajthitur,
U sula tutje kot më kot.
Prisha kasolle dhe mullarë,
Portale çezmash e shtëpish.
Oh, isha bërë si e marrë
Për bukurinë që m'u prish!
Dhe, si më ra tërbimi i parë,

U ktheva prapë e ika shpejt;
Mbuluar pluhur edhe kashtë,
Shëmtuar, bërë mos më keq.

Në oficinë ustallarët
Më riparuan helm e pikë.
Më bënë arnime në lëkurë,
Siç bëjnë operacion plastik.
Më lyen anembanë me bojë,
Ciflosjet fshehën me kujdes.
Kështu që prapë e bukur isha,
Kur dola udhës një mëngjes.
Vrapoja vrullshëm, mitralozin
E mbaja lart me krenari.
S'besoja kurrë se do guxonin
Të më goditnin përsëri.
Por, oh, s'kaluan as dy ditë,
Kur më qëlluan prapë ata.
Bombat m'i shtypën krejt turinjtë
Dhe trupi anembanë m'u ça.

U sula e tërbuar prapë,
T'i zhduk, t'i shtyp, t'i shkel përdhe,
Por s'i arrita dot, e vetme
Nisa zvarritjen në xhade,
Zinxhirët keq m'ishin dëmtuar,
Dhe mezi ikja çalë-çalë,

Ashtu siç bën njeriu i mjerë,
Që këmbën në një gozhdë ka çarë.
Oh, sa e tmerrshme ish kjo ikje,
Kur e kujtoj, dridhem sërish.
Dhe prapë u gjenda n'oficinë,
Por këtë herë seriozisht.
Nuk kisha vetëm ca gërvishtje,
Isha dëmtuar rëndë e keq.
Dhe tundnin kokat mekanikët,
Ndërsa më vinin rreth e rreth.
Dukej sikur thoshin me vete:
Gjynah, se ç'bukuroshe ish!
Dhe përmbi trupin tim të shëmbur
Nisën goditjet me çekiç.

Në oficinë qëndrova gjatë
Dhe ish mërzi dhe brengë ish.
Megjithse kishte autoblanda,
Madje dhe tanke atje kish.
Ata më shihnin, buzëqeshnin,
Ti, autobлиндë, je e re,
Në këtë vend veç kështu presin;
Shiko se ç'plagë kemi ne.
Dhe më tregonin kullat, tytat,
Zinxhirët e coptuar krejt.
Dhe unë tmerrohesha e thosha
Me vete: paska dhe më keq.

Më në fund dola nga ofiçina;
Nga pamja s'njihesha aspak.
Unë bukuroshja, sinjorina,
Seç isha kthyer në një plakë.
Trupi me arna, gjithë i qepur,
Salduar shpina mos më keq,
Kur më shikonin, më thërritnin
Me emrin «shtrigë» ose «dreq».
Në dy-tri luftra mora pjesë,
Por më dëmtuan përsëri,
Zinxhirët duke hequr zvarë,
Se si shpëtova, as vetë s'e di.

Kështu kalonin javët, muajt,
Gjersa erdh' dita më në fund
Bashk' me togerin që më ngiste,
Më zunë rob në një katund.
O, ç'turp i madh për mua ishte,
Në mes të fshatit, mu në shesh,
Përsipër pulat më kakarisnin,
Dhe kalamajtë loznin përreth.

Dhe partizanë dhe katundarë
U mblodhën gjithë në lëndinë
Që të vendosnin ç'do të bënin
Me mua, zonjën autobлиндë.
Ca thanë që të më shqepnin fare

Edhe nga trupi i hekurt i im,
Të bënin plugje për ugare,
Të bënin kazma dhe drepinj.
Të tjerët thanë që të më hidhnin
Në një humnerë (O, ç'tmerr që ish)!

Atje të dergjesha përjetë,
Gjersa të kthehesha në ndryshk.
Por më në fund u çua njëri,
Që e kish emrin komisar.
Dëgjoni, shokë, ai foli,
Të them dhe unë nja dy-tri, fjalë:
Këtë makinë të urryer,
Që rob e zumë këtë herë,
Të mos e bëjmë as plug as drapër
Dhe as ta hedhim në humnerë.
Unë them për tjerër gjë ta ruajmë
Këtë makinë, këtë lubi.
Së shpejti lufta do mbarojë
Dhe do të bëhet histori.
Fëmijët tanë, nipat tanë,
Ata që do të vijnë pas nesh,
Sa do të duan që të dinë
Për këtë luftë, këtë rrebesh.
Të dinë heronjtë që luftuan
Në dimra, male në stuhi,
Të dinë armiqtë që u mundën,
Armët e tyre pa lavdi.
Prandaj ta ruajmë autoblindën,

Ta ruajm' shtrigën për muze.
Fshatarët gjithë brohoritën:
Si thua ti do bëjmë ne.
Kështu ata më ruajtën m'ua,
Gjersa më sollën në muze...
Kjo ishte jeta ime e shkurtër,
Më shumë turp, se jetë qe.

UDHËZIM PËR VIZITORËT

Këto që foli autoblanda,
Janë të vërteta gjithsesi.
Fshatarët, kur këtu e nisën,
Asaj i dhanë porosi:

Atje të thuash të vërtetën,
Se mos gënjesh atje, moj shtrigë...
Ndaj dhe ajo i thotë ngjarjet
Ashtu siç ndodhën pikë për pikë.

Tani ta lëmë atë mënjanë,
Një tjetër armë na pret tani.
Krejt në ndryshim me autobлиндën
Ajo është mbushur me lavdi.

Dhe është e vogël krejt kjo armë
Përpara autoblindës, shih.
Veç historinë e ka të madhe
Ky revolver nëpër stuhi.

UDHËZIM PËR VISITORIN

Për të kët autoblindë,
Tani të vërtetë gjithë,
Përparësi kur të vërtetë
Ajo të vërtetë.

Ajo të vërtetë të vërtetë,
Për mos kujtesh ajo, mot shpirtit,
Ajo të vërtetë ajo të vërtetë,
Ajo të vërtetë ajo të vërtetë.

Tani të vërtetë ajo të vërtetë,
Ajo të vërtetë ajo të vërtetë,
Ajo të vërtetë ajo të vërtetë,
Ajo të vërtetë ajo të vërtetë.

REVOLJA E ATENTATORIT

Kjo revole e Hulos.
Vallë ç'do të tregojë:
Gjashtë plumba kishte,
Të shtatin në gojë.

I shtati në gojë,
Gati për të dalë...
Spiuni Maksut
Ja, po bre dh ngadalë.

Mu në mes të lagjes
Spiuni Maksut
Nga rrugica doli,
Në rrugicë u fut.

Po spiunon djemtë
Spiuni me nam,
Ca në burg i futi,
Ca më thellë i kanë.

Ca nëpër trikëmbështa
Tunden natë e ditë,
Spiuni Maksut,
T'u paksuan ditët.

2

Në shtëpinë e varfër,
Mu në rrëzë të malit,
Po pastron revolen
Hulo ilegali.

Revole, revole,
Do të gdhijë pas pak,
Ne të dy do dalim
Prapë nëpër sokak.

Në sokak të ngushtë,
Ku na mblodhi ora,
Maksutin e njihje,
Hajde bëja fora.

Revole, revole,
Kaq ditë e kaq net,
Ne të dy s'u ndamë
Me muaj me vjet.

Kapiten Xhovani
Të kujtohet vallë,
Kur ia numërove
Të shtata në ballë?

Dhe pas kapitenit,
Prefekti Dervish,
Që, tek jepte shpirt,
Lutej arabisht.

Dhe spiuni Jani,
Dhe majori Shvarc,
Në kalldrëm të gurtë
Koka ç'iu përplas.

Revole, revole,
punë kemi sot:
Spiunin Maksut
Ta dëbojmë nga kjo botë.

Armën tek pastronte,
Nënë e tij e pa.
Të të bëj një vezë,
Bir i im, i tha.

Të të bëj një vezë,
Të hash mëngjes.
Prit, moj nënë e dashur,
Prit, moj pëllumbeshë.

Veza, oh, ç'më hahet,
Se kam shumë uri.
Po s'ke vaj, moj nënë,
Po s'ke gjalpë ti.

U rrudhën, u ndritën
Me lot sytë e saj.
Ja ku ka, o bir,
Ja ku ka pak vaj.

Jo, moj nënë e dashur,
S'është për mua ai.
Vajin e revoles
S'e ha kursesi.

Tytën e revoles
Do vajos sot unë,
Se me një spiun
Ajo sot ka punë.

Do të vajos tytën,
Nën e dashur moj.
Në teproftë vaji,
Dhe un' do ngjëroj.

Po la gjë pa ngrënë
Tytë e saj e zezë,
Merre ti, moj nënë,
Dhe më bëj një vezë.

Ilegali Hulo
Këto fjalë tha.
Dhe mendonte nëna:
Ç'kohëra të mëdha.

Ndajnë djemtë vajin,
Me armët e ndajnë.
Këta djem të nënës,
Këta djem luanë.

Revolen në xhep,
 Ka dalë në sokak,
 Ilegali Hulo
 Ecën poshtë e lart.

Ai pret Maksutin,
 Po Maksuti s'vjen.
 Ku vërtitësh, vallë,
 O spiun, o qen?

Po spiun Maksuti
 S'duket në sokak,
 Se me miq është shtruar
 Sot në restorant.

Sot ka marrë rrogën
 Dhe me miq po pi.
 Rrogë e tradhëtisë,
 (O, ç'shpërblim i zi).

Me paratë e ndyra
 Q'armiku ia dha,
 Porosit Maksuti
 Gjellë e bakllava.

Porosit biftek,
Porosit hallva,
Dhe pirunin ngul,
Dhe qesh ha, ha, ha.

Dhe me miqtë e tij
Ngre dollinë «bromp»!
Të na rrosh, Maksut,
Maksut, të na rrosh!

Për shëndetin tënd,
Rrofsh e qofsh, Maksut....
Por në restorant
Hulua seç u fut.

Hulua i pangrënë,
Hulua pa mëngjes,
Hulua që s'kish vaj
Të bënte një vezë.

Në tryezë dollia
Kërcet brumb e bramb,
Hulua qetësisht
Ulet aty pranë.

Kamerieri i hollë,
Mbi parket rrëqesht,
Ç'urdhëroni, zotni?
Hulos po i flet.

Kemi pulë të pjekur,
Kotoletë, biftek,
Verë të kuqe, të bardhë,
Pasta me sherbet.

Kemi dhe të tjera
Kokë qengji, a?!
— Një kokë spiuni
Dua, — Hulua tha.

Kamerieri sytë
shqyen si hutaq,
Por revolen Hulua
E kish nxjerrë sakaq.

Dhe revolja e vogël
Gjashtë krisma dha.
Koka mbi pilaf
Maksutit i ra.

Fytyra me salcë
Mbi pjatë iu spërkat,
Ulërinë zonjat:
Maksuti e pat!

Ulërinë zonjat,
Tok me zotërinjtë.
Hulua nga dritarja
U hodh në rruginë.

Revole, revole,
Ç'më nderove ti.
Thoshte ndërsa ikte
Rrugës si veri.

Gjashtë plumba kishe,
Të shtatin në gojë...
Në mbrëmje do kemi
Shokëve ç't'u tregojmë.

5

O moj shtatshe e vogël,
Me çarkun e zi,
Për armiq, spiunë
Tmerr u bëre ti.

Hulua' si thesar
Me kujdes të mban.
Vajin ndan me ty,
Darkën me ty ndan.

Për Hulon armiqtë
Kanë nxjerrë një afish:
Kush të vrasë Hulon,
Shpërblehet dhejtëfish.

Do ta kapim Hulon,
Ulërijnë ata.
Do ta çojmë në burg,
Mbyllur në kala.

Revolen e tij
Do t'ia marrim, ha.
Të vrasim me të
shokë e shoqe ç'ka.

6 —

Dimri është i rreptë,
Bën ftohtë e stuhi.
Afishja për Hulon
Seç laget në shi.

Spiunë e zagarë
E kërkojnë kudo,
Po s'e zënë dot,
S'kapet Hulua, jo.

Hulua i Partisë,
Hulua ilegal.
Sot bre dh nëpër lagje,
Nesër gdhin në mal.

Dhe revolet e tij
Befas ia bën bam!
Kjo revolja e vogël,
Shtatshe e tij me nam.

7 -

Nënë pa e parë
Kishte ditë ai.
Malli e kish marrë
Ta shihte me sy.

Hulo, duro mallin,
Duro edhe pak.
Mos shko asaj udhe,
Tek ai sokak.

Se shtëpinë tënde
Ditë e natë përgjojnë.
Kthehu nga rruga, Hulo,
Kthehu sa s'është vonë!

Por, medet, ky Hulua
Nuk u kthye, ah.
Në kurth të armiqve
Ilegali ra.

Porsa hyri brenda,
Nënëen sa e pa,
Një zë i tmerruar
Dorzohu! — i tha.

Edhe pa ky Hulua
Armiqtë përreth.
Hungrima ballistësh
Edhe lehje qensh.

Mirupafshim, nënë,
Befas ai tha.
Dhe nxori revolen
Dhe shtiu përmbi ta.

Krisma, ulërima,
Zjarr e tym i zi.
Hulua po përpiqet,
Të dalë mbi çati.

Ka një plagë në shpatull,
Një tjetër në bark,
Po nuk jepet Hulua,
Ngjitet në oxhak.

Nga majë e pullazit
Vazhdon të qëllojë.
Revole me gjashtë,
Të shtatën në gojë.

Armiqtë kanë urdhër
Ta zënë të gjallë.
Zvariten pullazit,
Rrëzohen në shkallë.

Çati më çati,
Oxhak më oxhak.
Hulua po largohet
Dhe pak, ah, dhe pak.

Bramb e brumb nga çizmet
Gjëmon çdo pullaz
Mbi ta ikën Hulua,
Ata rendin pas.

Çati më çati,
Oxhak më oxhak...
Ka një plagë në shpatull,
Një tjetër në bark.

Gjëmojnë çatitë
Nga çizmet bramb brumb.
Hulua humbet gjurmët,
Zbet në një bodrum.

Është bazë e luftës,
Shokët atje ka.
Plagët i mjekojnë
Shpejt e shpejt ata.

Shokë, thotë Hulua,
O shokët e mi,
Sytë po më erren,
Dhe shpina m'u ngri.

Ja revolja shokë,
Amanet e lë.
Me të më kujtoni
Mua gjithënjë.

Do t'ia dëgjoj krismën
Sa herë të gjëmojë...
Gjashtë plumba brenda,
Të shtatën në gojë.

Kaq tha ilegali
Edhe frymën dha...
Dimri erdh i egër,
Bari krejt u tha.

8

Armiqtë e tradhëtarë
Thërrasin në qytet:
Heshti armë e Hulos,
Si i zoti vetë.

Mirëpo një mesditë,
Në një kafene,
Krisi armë e Hulos,
Sikur gjallë të qe.

Gjashtë plumba radhas,
Të shtatin në gojë.
Armiqtë u tmerruan,
Se krismën i njohën.

Pa u hapën fjalë:
Hulua prapë u ngjall.
Po Hulua dergjet
Atje thellë në varr.

Hulua është thellë,
Por mbi botë lart
Ka lënë ai zemrën,
Dorë dhe ideal.

Dorë e tij me dorë
Të shokëve godet.
Edhe krismë e armës
Ndihet thellë në dhet.

Kjo qe historia
E armës së tij.
Në varr e dëshmorëve
Hulua është tani.

Është atje me shokë,
Me lavdi atje.
Kurse armë e dashur
Ndodhet në muze.

Dhe kur çojnë lule
Atje ku ka rënë,
Një lule revoles
Gjithashtu i vënë.

UDHËZIM PËR VIZITORËT

E vogël kjo revole e rreptë,
Po sa të madhe e ka lavdinë...
Një armë tjetër po na pret,
Ose më mirë një mbeturinë.

Dikur avion ky krah ka qenë,
I çante qiejt si hata.
Lavdi s'ka pasur as atëherë,
Pa le tani që s'është veç krah.

KRAHU I AEROPLANIT

«*Mesershmit*»

Ky krah, si krah korbi,
Q'u shqit në tufan,
Është krah i avionit
Të egër gjerman.

Fluturonte mbi fusha,
Mbi male me nxit,
Aeroplani me emër
Të zi «*Mesershmit*».

«*Mesershmit*» sipër reve,
«*Mesershmit*» nën re.
Hidhte bomba mbi fshatra,
Herë këtu, herë atje.

Mitralonte xhadetë,
Digjte shkolla, shtëpi.
Vriste gjyshet dhe pleqtë,
Burra, gra dhe fëmijë.

Nëpër zonat e lira,
Me pushtet popullor,
Fluturonte avioni
Për të mbjellë terror.

Shfaqej befas në qiell,
Në të kthjellt si rrufe.
«Mesershmit» sipër reve,
«Mesershmit» nën re.

E ngiste piloti
Me emrin Ludvig.
Është vështirë të gjendej
Një pilot më i lig.

Gjithsaherë hidhte bombat,
Ç'bomba ah, të mëdha,
Shqyhej gazit Ludvigu,
Hu, hu, hu, ha, ha, ha.

Bjerë, bjerë ti, moj bombë,
Ngrihu lart tym i zi.
Edhe qeshte Ludvigu,
Ha, ha, ha, hi, hi, hi.

Edhe tymit që ngrihej
Ia bënte me dorë.
Sikur t'ish një i njohur
I vjetër, mizor.

Mbi gërmadhat e zeza,
Mbi kufomat vargan,
Kthehej prapë aeroplani,
I egri gjerman.

Kthehej prapë që t'i shihte,
Të kënaqej sërish.
Pastaj ikte i lumtur
Përmes reve kjo bishë.

Dhe mallkimi i nënave
Pas e ndiqte mes resh:
U rrëzofsh Mesershmit,
Mesershmit, qafën thefsh!

Por avionët mallkimet,
Dot s'i rrëzojnë.
Duhet predhat e topave
Që u thonë kundrajrorë.

Partizanët nuk kanë
Kundrajrorë në mal...
Ndaj lëviz Mesershmiti
Herë më shpejt, herë ngadalë.

Ndaj lëviz Mesershmiti
Her' këtej, herë matanë.
Partizanët kanë pushkë,
Por për ajër topa s'kanë.

S'kanë ata kundrajrorë,
Topa ajri s'kanë sot.
Veç urimin e nënave
Kanë «T'u bëftë pushka top».

Përmbi marka fabrikash,
Që kanë pushkët në shpinë,
Mbi të dhënat teknike,
Seç u ngrit ky urim.

Ky urim thyen ligjet
E shkencave sot:
Topi i madh bëhet pushkë,
Pushkë e thjeshtë bëhet top.

Nga një pllajë, një lëndinë,
Nën qiell të paanë,
E vështron Mesershmitin
Partizani Luman.

Porsi shokët e tij
Veç një pushkë ai ka.
Mesershmiti që larg.
Po afrohet mbi ta.

Mërmërit partizani,
Po afrohesh «o qen».
Shtrihet shpejt përmbi shpinë,
Pushkën qiellit i kthen.

Pushkë e tij mijëra pushkëve
Partizane u ngjan.
Ç'markë pushkën e ke,
Partizani Luman?

Ç'emër ka edhe ç'markë
Rëndësi kjo s'ka sot.
Pushkë e tij është e markës:
«T'u bëftë pushka top!»

Ndaj u shtri shpejt në shpinë
Partizani Luman.
Ndaj e ktheu ai pushkën
Mbi avionin gjerman.

Lart, në qiell, Ludvigu,
I krekosur si gjel,
Zgjati kokën te xhami
Vështron poshtë në zabel.

Dhe dalloi partizanët
Edhe qeshi ha, ha.
Ç'do t'i vdes unë së shpejti,
Ç'do të qesh pak me ta.

Pa drejtoi mitralozin
Edhe ra në pikiadë.
Mitratoi rreth e rrotull
Dhe në qiell u ngrit prapë.

Eh, nuk keni ku ikni,
Eh, ç'ju zura në kurth.
Kështu qeshi Ludvigu
Dhe mbi ta prapë u sul.

U vërsul porsi bishë
«Mesershmiti» gjerman.
Që nga poshtë mori shenjë
Partizani Luman.

Që nga lart, porsi breshër,
Ranë plumbat përqark.
Kurse plumbi i Lumanit
Që nga poshtë u ngjit lart.

Ata ishin me qindra,
Kurse një ai qe.
U kryqëzuan në erë,
Nën qiellin me re.

U kryqëzuan në erë,
U duk sikur thanë
Ca fjalë të shkurtra
N'atë erë, tramundanë.

Ç'je ti, more plumb,
Që po ngjitesh përpjetë?
Si guxon të çash qiellin.
Si guxon të shposh retë?

Si guxon të goditësh
Avionin gjerman?
Kthehu pas, sa s'është vonë.
O, ti plumbi shkretan!

Po ky plumbi i Lumanit
Fishkëlliu që poshtë:
Unë jam plumbi i lirisë,
Unë jam plumbi — top!

Edhe drejt në motor
Aeroplanit i ra.
Motorin si zemër
Avioni e ka.

U lëkund aeroplani,
Mesershmiti krenar.
Pa filloi të rrëzohej
Me një bisht tym e zjarr.

I tmerruar shqeu sytë
Piloti Ludvig.
Ish vështirë që të gjendej
Pilot më i lig.

E harroi krekosjen,
Krenarinë seç e la.
E braktisi avionin
Dhe u hodh në hava.

Nëpër erë parashuta
Po binte ngadalë.
«Po të presim!» që poshtë
Partizanët i thanë.

Përpëlitej në erë
Piloti Ludvig.
Ish vështirë të gjendej
Pilot më i lig.

Seç e kapën, e lidhën,
E çuan në fshat.
Dyll i verdhë Ludvigu
Qante, fliste përçart.

Pa u mblodhën fshatarët,
Burra, gra edhe pleq.
Ta gjykojmë Ludvigun,
Kriminelin e keq.

— Nga je? — pyetën pleqtë, —
Dhe ç'emër ti ke?
Pse ke ardhur këtu,
Ç'punë kishe me ne?

Gjyqi ishte i shkurtër
Dhe të shkurtra qenë pyetjet,
Ky piloti Ludvig
U dënua me vdekje...

Pa e morën, e lidhën,
Te skeleti i avionit.
E afruan avionin
Te buzë e një honit.

Ti me të fluturoje?
Fluturo me të prapë.
Në humnerë thyej kokën,
O Ludvigu i prapë!

Edhe ra në humnerë
Piloti Ludvig.
Ish vështirë që të gjendej
Pilot më i lig.

Me avionin së bashku,
Me skeletin e tij,
U bë copë, u bë çikë
Ky nazist sterrë i zi.

Nga avioni i vdekjes,
«Mesershmiti» barbar,
Teproi veç ky krah,
Si krah korbi i vrrarë.

Kur muzeu i armëve
U hap në kala,
Sollën krahun fshatarët
Edhe ikën ata.

Kështu ndodh ndonjë mbrëmje,
Kur fshatarët në mal
Vijnë e sjellin lëkurën
E një bishe të vrrarë.

UDHËZIM PËR VIZITORËT

Ky qe avioni «Meesershmit»
Dhe përfundimi i tij ky qe.
Mbi re ca muaj bëri zhurmë
Do heshti me shekuj në muze.

Dhe tani krahu i tij i vdekur,
I ftohti alumin i tij,
Lëshon një rrëzëllim të mekur
Atje në qoshe, në qetësi.

Dhe pranë i ri avioni tjetër,
Spiun i zi amerikan.
Një natë të errët, mbi ca fusha,
Atë e zunë pilotët tanë.

Ai nuk flet, veç herë-herë
Bën një pësh-pësh dhe pastaj hesht.
Ne para tij nuk do ndalojmë,
Sepse prej tij asgjë s'merr vesh.

Gjithmonë i fshehtë motorshuar,
Lakuriq nate, gjersa e zunë...
Spiun ka qenë ai gjithë jetën
Edhe pas vdekjes mbet spiun.

NETËT DHE DITËT NË MUZE

Dhe kështu shkojnë ditët
Në muzeun e madh.
Por, pas ditëve, vijnë netët,
Mbyllen portat ngadalë.

Pasi mbyllen dyert
Me kërkëllimë,
Si përherë armët
Fillojnë pëshpërimën.

Njëra-tjetrën e njohin
Fare mirë tani.
Bisedojnë nëpër qoshe
Një nga një, dy nga dy.

Hollësira të ndryshme
Tregojnë varg,
Psherëtijnë tytät,
Përloten nga pak.

Ja, topi gjerman
Me topin turk
Atje në qoshe
Seç flasin qyshkur.

Ç'kalibër ke ti?
Pyet turku i rëndë,
Siç pyet fqinji fqinjin
Për numrin e këmbës.

I thotë Haufmani
Kalibrin e tij,
Por turku tund tytën
Me qesëndi.

Të vogël e paske
Kalibrin, o mik.
Pa shih tytën time
Të gjerë si gjyryk.

He, he, thotë gjermani,
Ç'më qeshet tani.
Një gjyle në orë
Mezi hidhje ti.

Kurse unë njëqind gjyle
I hidhja vargan.
Kot nuk më thoshin
Topi Haufman.

Ha, ha, bëri turku,
Qeshi ha, ha.
Një gjyle unë hidhja,
Por ish gjyle ama

Një gjylja ime
Ish sa një shkëmb,
Kurse gjylet e tua
Binin përc-përc.

U nxeh Haufmani
Që gjylet ia shanë,
Thua se turku
I shau kalamanët.

Unë gjylet e vogla
I kam pasur një çikë.
Po mua s'më ka rrahur
Askush me kamzhik.

Nga kujtimi i rrahjes
U skuq topi turk,
Tyta e rëndë
U ul me turp.

Dhe nisën të shahen
Të dy plot me tmerr,
Me nënë e me babë,
Me Sulltan e Hitler.

Drejt njëri-tjetrit
Ngrejnë tytat ngadalë,
Por befas kujtohen
Se predha s'kanë.

Se kohë e tyre
Ka ikur e s'kthehet.
Se robër të dy
Janë në kështjellë.

Ja zonja autobлиндë
Midis tyre ndërhy, n,
Siç ndërhy nje zonjë,
Kur grinden dy zotërinj.

Ç'bëni kështu,
Nuk keni turp,
Zoti Haufman,
Dhe ju, zoti turk?

Harruat ku jeni,
Ku jemi gjithë ne?
Se robër përjetë
Po rrimë në muze?

Në vend që ju, topat,
Me peshën që keni,
Për gjithë ne të tjerët
Si shembull të jeni.

Ju zini të parët
Si kalamaj...
Ç'pret për armët e tjera.
Të bëjnë pastaj.

Kështu tha autoblanda
Midis heshtjes së thellë.
Rrinin armët kokulur
Në muze, në kështjellë.

Kaloi pak kohë
Dhe përsëri
Nisën prap pëshpërimat
Dy nga dy.

Nga qoshja një zë
Dëgjohet diku:
Si? si? Fol më fort
Ç'pëshpërit ashtu?

Pësh.. pësh..., I mallkuar
Spiun s'të marr vesh!
Por heshtja ndërkaq
Ka rënë përreth.

Ç'bëhet vallë në botë?
Dikush pyet ngadalë
Ç'armë të reja
Vallë kanë dalë?

Armë amerikane,
Sovjetike, ku ta dish.
Armë të rënda
Superfuqish.

Oh, oh, psherëtiu
Një top i vjetër.
Sido që të jenë,
S'do kenë fat tjetër.

Armët e tyre,
Ashtu si ne,
Do përfundojnë
Nëpër muze.

Dhe armët vazhdojnë
Murmurimën, në terr.
Ç'na gjeti, ç'na gjeti,
Psherëtijnë herë-herë.

Herë-herë ndihet
Një rënkim, një vaj.
Kështjella i bluan
Në muret e saj.

Kështu shkojnë netët
Atje, në muze,
Dhe orët shpejtojnë
Dhe gdhin ditë e re.

Dhe portat prapë hapen,
Hyjnë njerëzit vargan:
Punëtorë, fshatarë,
Ish-partizanë.

Nxënës të shkollave
Me zemrën prush.
Zhairima e tyre
Kështjellën mbush.

Njerëzit para armëve
Bisedojnë dy nga dy:
Ja pushka e Sulos,
Ja bombat e tij.

Ja topi i mallkuar
Që Teftën na vrau.
Ja shtriga autobлиндë,
Që hapi kaq varre.

Ja krahu i avionit
Gjerman, që ish në re.
Ja pushka e Lumanit,
Që e uli përdhe.

Tek armët e shokëve
Dëshmorë plot lavdi
Shpesh vënë lule
Njerëzit tani.

Te gryka e pushkës
Së dëshmorit Tafil
Ja dikush vuri
Një trëndafil.

Te revolveri
I atentatorit
Ca lule fushe
Vuri një dorë.

Topat e huaj,
Topat e mundur
Lulet mbi pushkë
Vështrojnë vëngër.

Sa ëndra patën
Këta topa barbarë,
Që në vendet e tyre
Të kthejnë fitmtarë,

Që t'i presin me këngë,
Me lule det...
Jo lulet, por balta
I mbuloi, medet.

Mbi tytat e gjata,
Mbuluar me ndryshk,
Një pikë loti
Rrjedh qetësisht.

Kurse mbi armët
E shokëve dëshmorë
Lulet, lavdia
Bëjnë kurorë.

UDHËZIM I FUNDIT PËR VIZITORËT

Dhe tani ora po afrohet,
Do mbyllet portë e rëndë tani.
Ne dalngadalë do të dalim
Që të vijmë nesër përsëri.

Orarin ju mos e shikoni...
Te ky muze i madh shqiptar,
Ne ditë e natë do të jemi
Përherë, përherë, pa orar.

Te ky muze ne do të vimë
Gjithmonë të jemi pranë lavdisë.
Përpara armëve të rrimë,
Siç rrimë përpara historisë.